

VENDIM
Nr. 185, datë 19.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 526, DATË 29.7.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikave 2 e 7, të nenit 14, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 526, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - a) Në pikën 3, fjalët “...”, si dhe të realizojë, të nxisë dhe të mbështesë nismat për një shoqëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve dhe shoqërisë civile” hiqen.
 - b) Shkronja “b”, e pikës 4, shfuqizohet.
 2. Shkronja “b”, e kreut II, shfuqizohet.
 3. Në kreun III bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - a) Në fjalinë e dytë të pikës 1, fjala “... janë ...” zëvendësohet me “... është ...”, ndërsa fjalët “... dhe “COD”” hiqen.
 - b) Në pikën 7 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - i. Shkronjat “dh”, “e”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” shfuqizohen;
 - ii. Në shkronjën “o”, fjalët “... veprimtarinë dhe aktivitetet e COD-it” hiqen.
 - c) Pika 8 shfuqizohet.
 4. Në logon zyrtare bashkëlidhur vendimit, të përmendur në pikën 10 të tij, hiqet logoja e COD-it.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama